



| | | | |
|---|---------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Prilbheno / Prilbato Received / Delivery | 28.04.2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit | Nr. Prot Br. Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPM/SACK | 2500/2022 | | 1/6 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.236/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca- anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.236/2022 të datës 16.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 28.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.236/2022 e datës 16.03.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Vendimi KA.Nr.9/2022 i datës 15.02.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, njoftimi përfundimtar i datës 29.12.2021, testimi i kandidatëve dhe lista e ngushtë e datës 15.12.2021 lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, e shpallur sipas konkursit Nr.Ref:KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ-021 të datës 15.11.2021.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshme i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës që brenda afatit prej pesëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu që procedura e rekrutimit si në pikën II të dispozitivit të vazhdojë nga përgatitja e listës së ngushtë.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 16.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1404/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.9/2022 të datës 15.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Pranimin në Shërbimin Civil, favorizimin e kandidatit të përzgjedhur si dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej referuar Këshilli) bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (tutje referuar SKPK), ndërsa më datë 04.04.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1404/2022 të datës 16.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës: Vendimin KA.Nr.9/2022 i datës 15.02.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ; Konkursin me numër reference KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ-021 për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores " Vazhdimin e konkursit për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores"; të datës 02.12.2021 deri 09.12.2021; Kërkesën me numër të protokollit 153/2022 të datës 23.03.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1792/2022 të datës 04.04.2022; Akt emërimin me numër DBNJ/DSKPK/525/2018 të datës 01.03.20218; Ankesën me numër 125 të datës 26.01.2022; Procesverbalin e datës 27.01.2022; Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të datës 29.12.2021; Konkursin e datës 15.11.2022 të shpallur në gazetën zyrtare; Vendimin me numër DPSKPK/432/2021 të datës 14.12.2021 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Emalin e datës 16.12.2021; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Raportin e datës 15.12.2021 lidhur me listën e ngushtë për pozitën " Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores"; Njoftimin e datës 16.12.2021 lidhur me testin me shkrim; Njoftimin lidhur me intervistimin me gojë; Listën përfundimtare të datës 15.12.2021 për përzgjedhjen e listës së ngushtë; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të listës së ngushtë të datës 15.12.2021; Deklaratën e datës 15.12.2021 për mosekzistimin e konfliktit të interesave të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit vlerësues; Listën përfundimtare të përzgjedhjes së testit me shkrim të datës 20.10.2021; Përmbledhja e vlerësimeve Individuale të testit me shkrim të datës 26.12.2021; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 23.12.2021; Formularët e vlerësimit individual të intervistës me gojë të datës 23.12.2021; Formularin përmbledhës të vlerësimeve individuale të datës 23.12.2021; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të datës 23.12.2021; Vlerësimet individuale përfundimtar të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj të datës 23.12.2021 Form.MAP-SHCK-08a; Çelësin e testit me shkrim për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores"; Deklaratën e datës 20.12.2021 për mosekzistimin e konfliktit të interesit të nënshkruar nga kandidati
Testin me shkrim të datës 20.12.2021 të kandidatit Deklaratën 20.12.2021 për mosekzistimin e konfliktit të interesit të nënshkruar nga kandidati Testin me shkrim të datës 20.12.2021 të kandidatit Deklaratën 20.12.2021 për mosekzistimin e

konfliktit të interesit të nënshkruar nga kandidati Testin me shkrim të datës
20.12.2021 të kandidatit Dëshminë e datës 26.11.2021 për dorëzimin e aplikacionit
të kandidatit Aplikacionin për punësim të kandidatit dhe dokumentet e
aplikimit: Form.MAP-SHCK-03; Certifikatën nga evidenca personale kundër të cilit nuk është duke
u zhvilluar procedure penale; Vërtetimin e datës 30.01.2018; Vërtetimin e datës 29.01.2018; shkresën
e datës 29.12.2017; Vërtetimet e punësimit të datës 10.05.2017, 24.07.2016, 28.01.2016, 23.01.2015;
Vërtetimin e datës 18.09.2020; Kontratën e punës për periudhën kohore 01.10.2018 deri me datën
01.10.2018; Kontratën e datës 01.02.2019-01.02.2019; Certifikatën me Nr.03/790 të datës 25.03.2015;
Formularin e vlerësimeve për rezultatet në punë të datës 16.02.2015 të kandidatit Akt
emërimin me numër 03-31 të datës 18.02.2014, Diplomën me Nr.552 të datës 18.09.2013, Diplomën
me Nr.1395 të datës 24.06.200; Certifikatën e vitit 2019, Certifikatën e datës 20.03.2008, Certifikatën
për pjesëmarrje në sesionin tetë javor të trajnimeve për kandidatë potencial të jurispodencës gjatë
periudhës Janar-Shkurt 2017, Certifikatën e vitit 2018; Referencën e datës 18.11.2014,
Rekomandimin e datës 18.11.2014, Referencën e datës 21.10.2014, Referencën e datës 17.11.2014,
Referencën e datës 21.10.2014, Vërtetimin e datës 30.01.2014, Certifikatën e vitit 2018; Certifikatën
për përfundimin me sukses të programit të mësimi klinik në drejtimin civil të realizuar në semestër
II të vitit akademik 2007/2008, Certifikatën për përfundimin me sukses të programit të mësimi
klinike në drejtimin penal të realizuar në semestrin e I-rë të vitit shkollor 2007/2008, Aplikacionin e
datës 25.11.2021 të kandidatit Diplomën e datës 30.04.2012, Vërtetimin me numër
112/226/2018 të datës 24.10.2018, Vërtetimin e datës 22.11.2021, Certifikatën nga evidenca e
personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale e personave të dënuar nga
Gjykata, Dokumentin e identifikimit, Aplikacionin me numër 1571 të datës 23.11.2021 të kandidatit
Diplomën me Nr.821 të datës 30.11.2009, Diplomën me Nr.120 të datës 13.06.2019,
Akt emërimin me numër ZBNJ/DP-474/2013 të datës 15.07.2013, Akt emërimin me numër
ZBNJ/DP-474/2014 të datës 14.07.2014, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës
31.12.2018, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 18.12.2019, Formularin për
vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.12.2020, Akt emërimin me numër 03 112-102 të datës
06.11.2012, kontratën e datës 21.12.2010, Kontratën e datës 18.02.2011, Kontratën e datës
20.04.2011, Kontratën e datës 22.06.2011, kontratën e datës 05.09.2011, Certifikatën e datës 05.02.2007,
Shkresën e datës 19.01.2011, Shkresën e datës 22.04.2011, Certifikatën e datës 30-31.07.2018,
Certifikatën e datës 04.04.211, Kontratën për praktikë në punë për periudhën kohore 13.05.2010-
12.08.2010, Diplomën me numër 0006011 të datës 25.05.2002, Certifikatën e datës 31.10.2010,
Certifikatën e datës 18.02.2010, Certifikatën e datës 20.05.2010, Diplomën e datës 18.03.2003,
Certifikatën e datës 08.05.2007, Certifikatën e datës 12.04.2001, Referencën e datës 23.11.2021,
Certifikatën e Personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të
dënuar nga kjo gjykatë, Dokumentin e identifikimit të kandidatit; Dëshmi për dorëzimin e
aplikacionit të datës 02.12.2021 të kandidatit Ndryshim dhe plotësimin e Aktit të
emërimit me numër 01 112/02-16391 të datës 07.07.2017; Certifikatën e datës 16.12.2014,
Certifikatën e datës 21-23.12.2015, Certifikatën e datës 28-29.09.2015, Vërtetimin e marrëdhënies së
punës të datës 25.11.2021, Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe
nëpunësve të shërbimeve publike të datës 28.12. Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të
datës 27.12.2019, Certifikatën me numër Ref.nr.03-16/98 të datës 02.06.2016, Vendimin me numër
Nr.112/02-24021 të datës 25.08.2021, Certifikatën e datës 15.16. 09.2016, Certifikatën për pjesëmarrje
në trajnim tre ditor për "Ndërmjetësimin ne Komunitete" për periudhën Mars 2018, Certifikatën e
shtetësisë me numër 36571/L13, Vërtetimin e datës 07.01.2014, Vërtetimin e datës 04.01.2010,
Certifikatën me numër Nr.207/2008 të datës 07.07.2009, Certifikatën me numër Nr.273/2008 të

datës 07.07.2009, Njoftimin për kandidatin e suksesshëm me Nr.prot.01/111/01-3693 të datës 30.06.2017, Shkresën e datës 28.09.2018, Vërtetimin lidhur me praktiken vullnetare për periudhën Prill 2011, Vërtetimin me numër Nr.01/2013 të datës 13.12.2013, Certifikatën e datës 23.07.2009 lidhur me përfundimin e studimeve bachelor të kandidatit, Diplomën me numër Nr.1121 të datës 07.04.2016. Dëshminë për dorëzimin e aplikacionit të datës 03.12.2021 të kandidatës Diplomën me numër Nr. 436 të datës 30.09.2008, Diplomën me numër Nr.409 të datës 19.03.2013; Certifikatën me numër Nr.34/2016 të datës 15.04.2016; Akt emërimit me numër DBNJ/DBSKPK-687/2019 të datës 04.07.2019; Vërtetimin me numër Nr.230/2021 të datës 23.11.2021; Formularin për vlerësimet e punës provuese të datës 02.06.2020; Certifikatën me numër NR.207/2008 të datës 07.07.2009; Certifikatën me numër Nr.273/2008 të datës 07.07.2009; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 27.12.2019; Referencën e datës 07.04.2017; Referencën e datës 15.11.2012; Dokumentin e identifikimit të kandidatës Aplikacionin me numër 1583 të datës 01.12.2021 të kandidatit Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga kjo Gjykatë; Akt emërimit me numër DBNJ/DSKPK/252/2018 të datës 01.03.2018; Akt emërimit me numër ZBNJ/DP-473/2014 të datës 01.02.2014; Kontratën e punës me numër 473/2015/PTH-GJA të datës 20.10.2015; Kontratën e punës me numër 13/GJA-PPK të datës 30.11.2009; Diplomën me numër Nr.1008/2015 të datës 24.06.2015 të kandidatit me të cilën mori titullin LLB në Juridik; Dokumentin e identifikimit të kandidatit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit

SEPSE:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 15.11.2021 ka shpallur Konkursin Nr.Ref KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ-021 për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Shkrimore* në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Konkursi ka qenë i hapur nga data 15.11.2021 deri me datë 29.11.2021 i vazhduar deri me datë 09.12.2021, ndërsa interesim konkurrimi ka shprehur gjashtë (6) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesin. Në listën e ngushtë të datës 15.12.2021 si kandidatë që kanë plotësuar kushtet formale të konkursit janë përzgjedhur pesë (5) aplikues përfshirë edhe ankuesin i cili i është nënshtruar me tej të gjitha fazave të vlerësimit gjegjësisht vlerësimit me shkrim me datë 20.12.2021 dhe intervistës me gojë me datë 23.12.2021. Bazuar në Njoftimin për Përzgjedhje të përfundimtare të datës 29.12.2021 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të SKPK-së, kandidati është shpallur si kandidati me i suksesshëm me gjithsej 70.7 pikë.

Ankuesi i pa kënaqur me Njoftimin përfundimtar, me datë 29.12.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së. Ky i fundit me Vendimin me numër KA.Nr.09/2022 të datës 15.02.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 29.12.2021 për zgjedhjen e kandidatit të suksesshëm.

Ankuesi kundër Vendimit KA.Nr.09/2022 të datës 15.02.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të Rregullores Nr.02/2010 për Pranimin në Shërbimin Civil, favorizimin e kandidatit të përzgjedhur si dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ju referua Aktgjykimit me numër reference AGJ 1583/20 të

datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe si rrjedhojë ka gjetur së Gjykata Kushtetuese në pikën III të aktgjykimit ka konstatuar se: Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: *Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokuroria të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë. Andaj, në kuptim të këtij aktgjykimi Kolegji vlerëson se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në raport me Këshillin Prokurorial zbatohet Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.*

Sipas Konkursit Ref.KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ-021, për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores në Prokurorin Themelore në Gjakovë si kriteret themelore janë përcaktuar: *Diplomë e Fakultetit Juridik ose Administratë Publike; dhe minimumi katër (4) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimit të ankuesit ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të ankuesit dhe si pasojë ka konstatuar se i njëjti sipas Diplomës 1008/2015 të datës 13.08.2015 ka përfunduar studimet themelore universitare me datë 24.06.2015 në programin Juridik të Përgjithshëm, ndërsa lidhur me përvojën e punës sipas Kontratës së Punës Nr.13/GJA-PPK ka punuar si Zyrtar i Sigurimit nga data 30.11.2009 deri 29.11.2012 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, Sipas Kontratës së Punës pa afat Nr.473/2015/PTH-GJ ka punuar si Vozitës nga data 20.10.2015 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ndërsa sipas Akt Emërimit DBJ/DSPK/525/2018 të datës 01.03.2018 ankuesi me datë 01.03.2018 është emëruar dhe ushtron pozitën Referent i Lartë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë. Andaj nisur te gjeturat si me lart ankuesi nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës respektivisht i njëjti deri në mbylljen e konkursit më datë 09.12.2021 nuk ka pasur 4 vjet përvojë pune profesionale pas diplomimit ngase vetëm puna Referent i Lartë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë njihet si përvojë e punës profesionale, e mbi këtë bazë rezulton se Komisioni Përzgjedhës me përfshirjen e ankuesit në listë të ngushtë pa plotësimin e kriterëve të pozitës së shpallur, ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathtësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë, rrjedhimisht çdo veprim tjetër procedural i pasuar lidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores në Prokurorinë Themelore në Gjakovë konsiderohet juridikisht i pavlefshme në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Bazuar në rrethanat si me sipër dhe meqenëse akti i shpalljes së konkursit nuk është i përfshirë me të meta procedurale dhe materiale, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi që procedura e rekrutimit për pozitën *Udhëheqës i Sektorit të Shkrimores* në Prokurorinë Themelore të Gjakovës të anulohet nga përgatitja e listës së ngushtë deri në shpalljen e kandidatit të suksesshëm, duke udhëzuar organin e punësimit të vazhdoj procedurën e konkurrimit nga faza e përgatitjes së listës së ngushtë siç është përcaktuar me nenin 19 ndërlidhur me nenin 24 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.


Kështu që, pas konstatimit të të gjeturave si me lartë si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.Nr.236/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

